

I

(Aktet e miratuara sipas Traktatit të KE-së/Traktati i Euroatomit publikimi i të cilit është i detyrueshëm)

DIREKTIVAT

DIREKTIVA 2007/2/KE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT

e Mars 2007

e cila themelon një Infrastrukturë për Informacionin Hapësinor në Komunitetin Evropian (INSPIRE)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti Nenin 175(1) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke marrë parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian ⁽¹⁾,

Pas konsultimit me Komitetin e Rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e caktuar në Nenin 251 të Traktatit, në kuadër të tekstit të përbashkët nga Komiteti i Pajtimit më 17 Janar 2007 ⁽²⁾,

Ndërkohë:

(1) Politika e komunitetit mbi mjedisin duhet të synojë një mbrojtje të nivelit të lartë duke marrë parasysh diversitetin e situatave në rajone të ndryshme të Komunitetit. Veç kësaj, informacioni, përfshi informacionin hapësinor, është i nevojshëm për formulimin dhe implementimin e kësaj politike dhe politikave të tjera të Komunitetit, të cilat duhet të integrojnë kërkesat e mbrojtjes mjedisore në përputhje me Nenin 6 të Traktatit. Në mënyrë që të realizohet

⁽¹⁾ OJ C 221, 8.9.2005, faq. 33.

⁽²⁾) Opinioni i Parlamentit Evropian i 7 Qershor 2005 (OJ C 124 E, 25.5.2006, faq. 116), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit të 23 Janar 2006 (OJ C 126 E, 30.5.2006, faq. 16) dhe Qëndrimi i Parlamentit Evropian i 13 Qershor 2006 (ende i papublikuar në Revistën Zyrtare). Vendimi i Këshillit të 29 Janar 2007 dhe rezoluta

legjislative e Parlamentit Evropian të 13 Shkurt 2007 (ende

integrimi, është e nevojshme të vendoset një masë koordinimi mes përdoruesve dhe ofruesve të informacionit që informacioni dhe njohuria të kombinohet nga sektorë të ndryshëm.

(2) Programi i Gjashtë i Veprimit ndaj Mjedisit miratuar me Vendimin Nr. 1600/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 22 Korrik 2002 ⁽³⁾ kërkon konsideratë të plotë për të siguruar që vendimmarrja e Komunitetit ndaj mjedisit të ndërmerret në një mënyrë të integruar, duke marrë parasysh ndryshimet rajonale dhe lokale. Ekzistojnë një numër problemesh në lidhje me disponueshmërinë, cilësinë, organizimin, qasjen dhe ndarjen e informacionit hapësinor të nevojshëm për të arritur objektivat e përcaktuara në programin përkatës.

(3) Problemet në lidhje me disponueshmërinë, cilësinë, organizimin qasjen dhe ndarjen e informacionit hapësinor janë të zakonshme për një numër të madh politikash dhe temash informacioni dhe provohen në të gjitha nivelet e ndryshme të autoritetit publik. Zgjidhja e këtyre problemeve kërkon masa që adresojnë shkëmbimin, ndarjen, qasjen dhe përdorimin e të dhënave të ndërveprueshme hapësinore dhe të shërbimeve të të dhënave hapësinore në të gjitha nivelet e ndryshme të autoritetit publik dhe sektorët e ndryshëm. Për këtë arsye duhet të krijohet një infrastrukturë për informacionin hapësinor në Komunitet.

(4) Infrastruktura për Informacionin Hapësinor në Komunitetin Evropian (Inspire) duhet të ndihmojë vendimmarrjen lidhur me politikat dhe aktivitetet, që mund të kenë një ndikim direkt ose indirekt mbi mjedisin.

(5) Inspire duhet të bazohet në infrastrukturën për informacionin hapësinor, që krijohet nga Shtetet Anëtare dhe se është i përputhshëm me rregullat e zakonshme të implementimit dhe plotësohen me masat në nivelin e Komunitetit. Këto masa duhet të sigurojnë që infrastrukturën për informacionin hapësinor krijohen nga Shtetet Anëtare dhe janë të përputhshme dhe të përdorshme në një Komunitet dhe kontekst ndërkufitar.

- (6) Infrastrukturat për informacionin hapësinor në Shtetet Anëtare duhet të projektohen për të garantuar se të dhënat hapësinore të ruhen, të bëhen të disponueshme dhe mirëmbahen në nivelin më të përshatshëm; se është e mundur të kombinohen të dhënat hapësinore nga burime të ndryshme në të gjithë Komunitetin në një mënyrë të qëndrueshme dhe t'i ndajnë ato mes një sërë përdoruesish dhe aplikacionesh; se është e mundur ndarja mes autoriteteve të tjera publike të të dhënave hapësinore të mbledhura në një nivel të autoritetit publik; se të dhënat hapësinore janë bërë të disponueshme sipas kushteve, që nuk kufizojnë padrejtësisht përdorimin e tyre të gjatë; se është e lehtë të zbulojnë të dhëna të disponueshme hapësinore, të vlerësojnë përshatshmërinë e tyre për qëllimin e duhur dhe të njohin kushtet e zbatueshme për përdorimin e tyre.
- (7) Ka një shkallë mbivendosjeje mes informacionit hapësinor përcaktuar nga Direktiva dhe informacionit përcaktuar nga Direktiva 2003/4/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 28 Janar 2003 mbi qasjen publike në informacionin mjedisor ⁽¹⁾. Kjo direktivë nuk duhet të ketë paragjykim ndaj Direktivës 2003/4/KE.
- (8) Kjo Direktivë nuk duhet të ketë paragjykim ndaj Direktivës 2003/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 17 Nëntor 2003 mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik ⁽²⁾, objektivat e të cilëve janë plotësuese ndaj atyre të kësaj Direktive.
- (9) Kjo direktivë nuk duhet të ndikojë në ekzistencën apo zotërimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të autoriteteve publike.
- (10) Themelimi i INSPIRE do të paraqesë vlerë të shtuar domethënëse për — dhe do të përfitojë gjithashtu nga — nisma të tjera të Komunitetit siç është Rregullorja e Këshillit (CE) Nr. 876/2002 të 21 Maj 2002 duke ngritur Sipërmarrjen e Përbashkët Galileo ⁽³⁾ dhe Komunikimin nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin 'Monitorimi Global mbi Mjedisin dhe Sigurinë (GMES): Ngritja e një kapaciteti të GMES brenda 2008 — (Plani i Veprimit (2004-2008)'. Vendet Anëtare duhet të marrin parasysh të dhënat dhe shërbimet, që rezultojnë nga Galileo dhe GMES në momentin që ato bëhen të disponueshme, në veçanti ato që lidhen me referencat kohore dhe hapësinore të Galileo.
- (11) Shumë nisma merren në nivel kombëtar dhe të Komunitetit për të mbledhur, harmonizuar apo organizuar përhapjen ose përdorimin e informacionit hapësinor. Nisma të tilla mund të krijohen nga legjislati komunitar, siç është Vendimi i Komisionit 2000/479/KE i 17 Korrik 2000 mbi implementimin e një regjistri Evropian të Emetimeve Ndotëse (EPER) sipas Nenit 15 të Direktivës së Këshillit 96/61/KE në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së integruar (IPPC) ⁽⁴⁾ dhe Rregulloren (EC) Nr. 2152/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 17 Nëntor 2003 lidhur me monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimeve mjedisore në Komunitet (Fokusi në pyje) ⁽⁵⁾, në strukturën e programeve të financuar nga Komuniteti (për shembull mbulimi tokësor CORINE, Sistemi Informativ Evropian mbi Politikën e Transportit) ose mund të burojë nga nismat e marra në nivel kombëtar ose rajonal. Kjo direktivë jo vetëm do të plotësojë nisma të tilla duke ofruar një strukturë, e cila do të mundësojë ndërveprimin e tyre, si dhe do të ndërtohen bazuar në përvojën ekzistuese në vend të dyfishimit të punës që është realizuar tashmë.
- (12) Kjo direktivë duhet të aplikohet për të dhëna hapësinore nga ose në emër të autoriteteve publike dhe për përdorimin e të dhënave hapësinore nga autoritetet publike në kryerjen e detyrave të tyre publike. Megjithatë, në varësi të kushteve të caktuara, ajo gjithashtu duhet të aplikohet për të dhëna hapësinore nga persona fizikë ose juridikë, përveç autoriteteve publike, me kusht që këta persona fizikë ose juridikë ta kërkojnë këtë.
- (13) Kjo direktivë nuk duhet të caktojë kërkesa për mbledhjen e të dhënave të reja, ose për raportimin e një informacioni të tillë para Komisionit, meqenëse këto çështje rregullohet nga legjislati të tjera lidhur me mjedisin.
- (14) Implementimi i infrastrukturave kombëtare duhet të jetë progresive dhe, në përputhje me rrethanat, temave të të dhënave hapësinore që përfshihen nga kjo Direktivë duhet t'iu akordohen nivele të ndryshme prioriteti. Implementimi duhet të marrë parasysh masën në të cilën këto të dhëna hapësinore nevojiten për një gamë të gjerë zbatimi në fusha të ndryshme politikash, të prioritetit të veprimeve ofruar sipas politikave të Komunitetit, që kanë nevojë për të dhëna të harmonizuara hapësinore dhe të progresit të kryer nga përpjekjet për harmonizim marrë përsipër nga Shtetet Anëtare.
- (15) Humbja e kohës dhe burimeve në kërkim të të dhënave ekzistuese hapësinore ose përcaktimi i faktit nëse ato mund të përdoren për një qëllim të caktuar është një pengesë kyçe për shfrytëzimin e plotë të të dhënave të disponueshme. Prandaj, vendet anëtare duhet të sigurojnë përshkrime të grupeve dhe shërbimeve të të dhënave të disponueshme hapësinore në formën e metadatave.
- (16) Meqenëse diversiteti i gjerë i formateve dhe strukturave në të cilat të dhënat hapësinore janë të organizuara dhe të aksesueshme në Komunitet vështirëson formulimin efikas, implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e legjislati komunitar, që direkt ose indirekt ndikon në mjedis. Duhet

⁽¹⁾ OJ L 41, 14.2.2003, fq. 26.

⁽²⁾ OJ L 345, 31.12.2003, fq. 90.

⁽³⁾ OJ L 138, 28.5.2002, fq. 1.

⁽⁴⁾ OJ L 192, 28.7.2000, fq. 36.

⁽⁵⁾ OJ L 324, 11.12.2003, fq. 1. Rregullorja amenduar nga Rregullorja (EC) Nr. 788/2004 (OJ L 138, 30.4.2004, fq. 17).

- të jepen masa në mënyrë që të lehtësohet përdorimi i të dhënave hapësinore nga burime të ndryshme në Shtetet Anëtare. Këto masa duhen projektuar për t'i bërë grupet e të dhënave hapësinore të ndërveprueshme dhe Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që çdo e dhënë ose informacion i nevojshëm për qëllim të arritjes së ndërveprimit është e disponueshme me kusht që të mos kufizojë përdorimin për atë qëllim të caktuar. Implementimi i rregullave duhet të bazohet, aty ku është e mundur, në standarde ndërkombëtare dhe nuk duhet të shkaktojë kosto të tepruara për Shtetet Anëtare.
- (17) Shërbimet e rrjetit janë të nevojshme për ndarjen e të dhënave hapësinore mes niveleve të ndryshme të autoritetit publik në Komunitet. Këto shërbime rrjeti duhet të mundësojnë zbulimin, transformimin, shikimin dhe shkarkimin e të dhënave hapësinore dhe të përdorë të dhënat hapësinore dhe shërbimet e tregtisë elektronike. Shërbimet e rrjetit duhet të funksionojnë në përputhje me specifikimet e pranuar përgjithësisht dhe kriteret e performancës minimale në mënyrë që të sigurohet ndërveprimi i infrastrukturës së ngritur nga Shtetet Anëtare. Rrjeti i shërbimeve përfshin gjithashtu mundësinë teknike për t'iu mundësuar autoriteteve publike të bëjnë të disponueshme grupet dhe shërbimet e të dhënave të tyre hapësinore.
- (18) Grupe dhe shërbime të caktuara të dhënash hapësinore lidhur me politikat e Komunitetit që ndikojnë direkt ose indirekt te mjedisi mbahen dhe operohen nga palë të tjera. Prandaj Shtetet Anëtare duhet t'iu ofrojnë palëve të treta mundësinë për të kontribuar në infrastrukturën kombëtare, me kusht që kohezioni dhe liria e përdorimit të të dhënave dhe shërbimeve hapësinore, të cilat mbulohej nga kjo infrastrukturë nuk dëmtohet në këtë mënyrë.
- (19) Përvoja me Shtetet Anëtare kanë treguar se për implementimin e suksesshëm të një infrastrukture për informacionin hapësinor është e rëndësishme që një numër minimal shërbimesh të bëhet i disponueshëm falas për publikun. Prandaj Shtetet Anëtare duhet të bëjnë të disponueshme, përkundrejt një tarife minimale ose falas, shërbimet për zbulimin dhe, si subjekt i kushteve të caktuara specifike, shikimin e grupeve të të dhënave hapësinore.
- (20) Në mënyrë që të ndihmojnë integrimin e infrastrukturës kombëtare në INSPIRE, Shtetet Anëtare duhet të ofrojnë qasje në infrastrukturën e tyre përmes një gjeo-portali të Komunitetit nga Komisioni, si dhe përmes çdo pike aksesi që ata vetë vendosin të operojnë.
- (21) Në mënyrë që t'i bëjnë informacionet e disponueshme nga nivele të ndryshme të autoritetit publik, Shtetet Anëtare duhet të heqin pengesat praktike me të cilat përballen autoritetet publike.
në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal gjatë kryerjes së detyrave të tyre publike, që mund të kenë një ndikim direkt ose indirekt te
- (22) Autoritetet publike kanë nevojë të kenë qasje të qetë në grupet dhe shërbimet përkatëse të të dhënave hapësinore gjatë ekzekutimit të detyrave të tyre publike. Një qasje e tillë mund të vështirësohet, nëse varet nga negociata individuale ad hoc mes autoriteteve publike çdo herë që kërkohet qasje. Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të parandaluar pengesa të tilla praktike në ndarjen e të dhënave, duke përdorur për shembull, marrëveshjet e mëparshme mes autoriteteve publike.
- (23) Aty ku një autoritet publik furnizon një autoritet tjetër publik në të njëjtin Shtet Anëtar me grupe dhe shërbime të dhëna hapësinore, që kërkohen për përmbushjen e raportimit të detyrimeve sipas legjislacionit komunitar lidhur me mjedisin, Shteti Anëtar përkatës duhet të jetë i lirë të vendosë që këto grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore nuk do t'i nënshtrohen asnjë tarifimi. Mekanizmat për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore mes qeverisë dhe administratave të tjera publike dhe personave fizikë ose juridikë, që kryejnë funksione publike administrative sipas ligjit kombëtar duhet të marrin parasysh nevojën për të mbrojtur qëndrueshmërinë financiare të autoriteteve publike, në veçanti ato që kanë detyrë të rrisin të ardhurat. Në çdo rast, çdo tarifë e aplikuar nuk duhet të kalojë koston e mbledhjes, prodhimit, riprodhimit dhe përhapjes njëherazi me një kthim të arsyeshëm të investimeve.
- (24) Dispozitat e shërbimeve të rrjetit duhet të zbatohen në përputhje të plotë me parimin e mbrojtjes të të dhënave personale sipas Direktivës 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 24 Tetor 1995 mbi mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave ⁽¹⁾.
- (25) Strukturat për ndarjen e të dhënave hapësinore mes autoriteteve publike mbi të cilat Direktiva imponon detyrën e ndarjes duhet të jenë neutrale për sa i përket këtyre autoriteteve publike brenda një Shteti Anëtar, por edhe për sa i përket autoriteteve të tilla publike në Shtete të tjera Anëtare dhe institucione të Komunitetit. Meqenëse institucionet dhe organet e Komunitetit vazhdimisht kanë nevojë për të integruar dhe fituar qasje në informacionet hapësinore nga të gjitha Shtetet Anëtare, duhet të mund të kenë qasje dhe përdorin të dhënat hapësinore dhe shërbimet e këtyre të dhënave në përputhje me kushtet e harmonizuara.
- (26) Me synimin për të nxitur zhvillimet e shërbimeve me vlerë të shtuar nga palët e treta, për të mirën e autoriteteve publike dhe vetë publikut, është i nevojshëm lehtësimi i qasjes në të dhënat hapësinore, të cilat shtrihen përtej kufijve administrativë apo kombëtarë.
- (27) Implementimi efektiv i infrastrukturave për informacionin hapësinor kërkon koordinim nga të gjithë ata, që kanë interes në ngritjen e një infrastrukture të tillë, qoftë si kontribues apo si përdorues. Për këtë duhen ngritur

- (1)) OJ L 281, 23.11.1995, fq. 31. Direktiva amenduar nga Rregullorja (KE) Nr. 1882/2003 (OJ L 284, 31.10.2003, fq. 1).

2006/512/EC (OJ L 200, 22.7.2006, fq. 11).

strukturat e përshtatshme të koordinimit, të cilat shtrihen në nivele të ndryshme qeverisëse dhe duhet të marrin parasysh shpërndarjen e kompetencave dhe përgjegjësiive brenda Shtetit Anëtar.

- (28) Në mënyrë që të përfitojnë nga infrastruktura e sofistikuar e informacionit dhe përvoja aktuale, është më se e përshtatshme që masat e nevojshme për implementimin e kësaj Direktive duhet të mbështeten nga standardet ndërkombëtare dhe standardet e miratuara nga organet evropiane të standardizimit në përputhje me procedurën e parashtruar në Direktivën 98/34/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 22 Qershor 1998 duke përcaktuar një procedurë për dispozitën e informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike ⁽¹⁾.
- (29) Qëkurse Agjencia Evropiane e Mjedisit ngritur nga Rregullorja e Këshillit (EEC) Nr. 1210/90 i 7 Maj 1990 mbi themelimin e Agjencisë Evropiane të Mjedisit dhe Informacionit dhe Rrjetin Evropian të Informacionit dhe Vëzhgimit të Mjedisit ⁽²⁾ ka detyrën e sigurimit të Komunitetit me informacion mjedisor objektiv, të besueshëm dhe të krahasueshëm në nivel komunitar, dhe synon, ndër të tjera, të përmirësojë rrjedhën e informacionit mjedisor të politikave përkatëse mes Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Komunitetit, pasi duhet të kontribuojnë në mënyrë aktive për zbatimin e kësaj Direktive.
- (30) Në përputhje me pikën 34 të Marrëveshjes Ndërinstitucionale mbi një ligjëvënie më të mirë ⁽³⁾, Shtetet Anëtare inkurajohen të hartojnë, për veten dhe në interes të Komunitetit, tabelat e tyre duke ilustruar, sa të jetë e mundur, lidhjen reciproke mes Direktivës dhe masave të zhvendosjes dhe për t'i bërë ato publike.
- (31) Masat e nevojshme për implementimin e kësaj Direktive duhet të adoptohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/EC të 28 Qershor 1999 ku parashtrihen procedurat për ushtrimin e implementimit të kompetencave të diskutuara në Komision ⁽⁴⁾.
- (32) Në veçanti, Komisioni duhet të autorizohet të adaptojë përshkrimin e temave ekzistuese të të dhënave në Aneksat I, II dhe III. Meqenëse masa të tilla janë të një fushe të përgjithshme dhe janë projektuar për të ndryshuar elementet jo thelbësore të kësaj Direktive, duhet të adoptohen në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese dhënë në Nenin 5a të Vendimit 1999/468/EC.
- (33) Komisioni duhet të autorizohet gjithashtu të adoptojë implementimin e rregullave ku parashtrihen marrëveshjet teknike për ndërveprimin dhe harmonizimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore, për rregullat që përcaktojnë kushtet lidhur me qasjen në grupe dhe shërbimeve të tilla, si dhe për rregullat lidhur me specifikimet dhe detyrimet teknike të shërbimeve të rrjetit. Meqenëse masa të tilla janë të një fushe të përgjithshme dhe janë

(1)) OJ L 204, 21.7.1998, fq. 37. Direktiva amenduar së fundmi nga Akti i Qasjes 2003.

(2)) OJ L 120, 11.5.1990, fq. 1. Rregullorja amenduar së fundmi nga Rregullorja (EC) Nr. 1641/2003 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (OJ L 245, 29.9.2003, fq. 1).

(3)) OJ C 321, 31.12.2003, fq. 1.

(4)) OJ L 184, 17.7.1999, fq. 23. Vendimi i amenduar nga Vendimi

projektuar të plotësojnë këtë Direktivë duke shtuar elemente të rinj jo thelbësorë, duhet të adoptohen në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese dhënë në Nenin 5a të Vendimit 1999/468/EC.

- (34) Puna përgatitore për vendimet lidhur me implementimin e kësaj Direktive dhe për zhvillimin e Inspire kërkon monitorim të vazhdueshëm të implementimit të kësaj Direktive dhe raportimit të rregullt.
- (35) Meqenëse objektivi i kësaj Direktive, domethënë ngritja e Inspire, nuk mund të arrihet në mënyrë efikase nga Shtetet Anëtare për shkak të aspekteve ndërshtetërore dhe nevojës së përgjithshme brenda Komunitetit për të koordinuar kushtet e qasjes, shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit hapësinor, dhe si pasojë mund të arrihet më mirë në nivel komunitar, Komuniteti mund të miratojë masa, në përputhje me parimin e subsidiaritetit përcaktuar në Nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, siç përcaktohet në atë Nen, kjo Direktivë nuk shkon përtej asaj çfarë kërkohet për të arritur këtë objektiv,

E KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Qëllimi i kësaj Direktive është të parashtrijë rregullat e përgjithshme, që synojnë ngritjen e Infrastrukturës për Informacionin Hapësinor në Komunitetin Evropian (më tej referuar si Inspire), për qëllim të politikave komunitare mbi mjedisin dhe politikat apo aktivitetet, që mund të kenë ndikim në mjedis.

2. Inspire do të ndërtohet mbi infrastrukturën për informacionin hapësinor, që është ngritur dhe operohet nga Shtetet Anëtare.

Neni 2

1. Kjo direktivë nuk cenon Direktivat 2003/4/KE dhe 2003/98/KE.

2. Kjo Direktivë nuk ndikon në ekzistencën apo zotërimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të autoriteteve publike.

Neni 3

Për qëllim të kësaj Direktive, do të zbatohen përkufizimet vijuese:

1. 'infrastrukturë për informacionin hapësinor' nënkupton metadata, grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore; shërbimet dhe teknologjitë e rrjetit; marrëveshjet mbi ndarjen, qasjen dhe përdorimin;

mekanizmat e koordinimit dhe monitorimit, proceset dhe procedurat e ngritura, që operojnë ose janë të disponueshme në përputhje me këtë Direktivë;

2. 'të dhëna hapësinore' nënkupton çdo të dhënë me një referencë direkte ose indirekte për një vendndodhje specifike ose zonë gjeografike;
3. 'grup të dhënash hapësinore' nënkupton një mbledhje të identifikueshme të të dhënave hapësinore;
4. 'shërbimet e të dhënave hapësinore' nënkupton operacionet që mund të kryhen, duke aktivizuar një aplikacion kompjuteri, në të dhënat hapësinore përfshirë në grupet e të dhënave hapësinore ose në metadatat përkatëse;
5. 'objekt hapësinor' nënkupton një prezantim abstrakt të një fenomeni të një bote të vërtetë lidhur me një vendndodhje specifike ose zonë gjeografike;
6. 'metadata' nënkupton informacionin që përshkruan grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore dhe mundësimin e zbulimit, inventarit dhe përdorimit të tyre;
7. 'ndërveprim' nënkupton mundësinë e kombinimit të grupeve të të dhënave hapësinore dhe ndërveprimin e shërbimeve, pa një ndërhyrje përsëritëse manuale, në një mënyrë të tillë që përfundimi të jetë koherent dhe vlera e shtuar e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave të rritet;
8. 'Gjeo-portali Inspire' nënkupton një faqe interneti, ose e barasvlershme me të, e cila ofron qasje në shërbimet e referuara në Nenin 11(1);
9. 'autoriteti publik' nënkupton:
 - (a) çdo qeveri ose administratë tjetër publike, përfshi organet publike të këshillimit në nivel kombëtar, rajonal ose lokal;
 - (b) çdo person fizik ose juridik, që kryen funksione publike administrative sipas ligjit kombëtar, përfshi detyra specifike, aktivitete apo shërbime lidhur me mjedisin; dhe
 - (c) çdo person fizik ose juridik që ka përgjegjësi ose funksione publike, ose që ofron shërbime publike për mjedisin sipas kontrollit të një organi ose personi ku bëjnë pjesë (a) ose (b).

Shtetet Anëtare mund të argumentojnë se kur organe ose institucione veprojnë brenda kapacitetit juridik ose legjislativ, nuk do të konsiderohen si autoritet publik për qëllim të kësaj direktive;

10. 'palë e tretë' nënkupton çdo person fizik ose juridik përveç autoritetit publik.

Neni 4

1. Kjo Direktivë do të përfshijë grupet e të dhënave hapësinore, të cilat plotësojnë kushtet vijuese:

- (a) ato lidhen me një zonë ku një Shtet Anëtar ka dhe/ose ushtruar të drejta juridiksionale;
- (b) janë në formatin elektronik;
- (c) mbahen nga ose në emër të ndonjërit nga të mëposhtmeve:
 - (i) një autoritet publik, pasi është prodhuar ose pranuar nga një autoritet publik, ose po menaxhohet ose përditësohet nga ai autoritet dhe që përfshihet brenda sferës së detyrave publike;
 - (ii) një palë e tretë për të cilën rrjeti është bërë i disponueshëm në përputhje me Nenin 12;
- (d) ato lidhen me një pse më shumë tema të listuar në Aneksin I, II ose III.

2. Në rast kur ka kopje të shumta identike të të njëjtës kulturë të dhënash hapësinore mbahen ose janë në emër të autoriteteve të ndryshme publike, kjo Direktivë do të zbatohet vetëm në versionin e referencës nga i cili rrjedhin kopjet e ndryshme.

3. Kjo Direktivë do të përfshijë gjithashtu shërbimet e të dhënave hapësinore në të dhënat ku mbahen të dhënat hapësinore në paragrafin 1.

4. Kjo Direktivë nuk kërkon mbledhjen e të dhënave të reja hapësinore.

5. Në rast të grupeve të të dhënave hapësinore, të cilat përputhen me kushtin e parashtruar në paragrafin 1(c), por palët e treta kanë të dhëna të pronësisë intelektuale në lidhje me këtë. Autoriteti publik mund të ndërmarrë veprim sipas kësaj Direktive vetëm me miratimin e palës së tretë.

6. Duke anashkaluar paragrafin 1, kjo Direktivë do të përfshijë grupet e të dhënave hapësinore nga ose në emër të një autoriteti publik duke operuar në nivelin më të ulët të qeverisjes brenda një Shteti Anëtar, nëse Shteti Anëtar ka ligje ose norma që kërkojnë mbledhjen ose përhapjen e tyre.

7. Përshkrimi i temave të të dhënave ekzistuese referuar në Aneksin I, II dhe III mund të përshtaten në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar në Nenin 22(3), në mënyrë që të merret parasysh zhvillimi i nevojave për të dhënat hapësinore në mbështetje të politikave komunitare, që ndikojnë në mjedis.

KAPITULLI II

METADATA

Neni 5

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që metadatat krijohen për grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore, që korrespondojnë me temat e listuar në Aneksat I, II dhe III dhe këto metadata mbahen të përditësuara.

2. Metadatat do të përfshijnë informacionin në vijim:

- (a) përshtatja e grupeve të të dhënave hapësinore me implementimin e rregullave parashikuar në Nenin 7(1);
- (b) kushtet që aplikohen për qasjen në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore dhe përdorimin e tyre dhe, sipas rastit, tarifatat përkatëse;
- (c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave hapësinore;
- (d) autoritetet publike përgjegjëse për ngritjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore;
- (e) kufizime të qasjes publike dhe arsytet për kufizime të tilla, në përputhje me Nenin 13.

3. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që metadatat të jenë të plota dhe të një cilësie efektive për të përmbushur qëllimin e përcaktuar në pikën (6) të Nenit 3.

4. Rregullat e implementimit të këtij Neni do të miratohen brenda 15 Maj 2008 në përputhje me procedurën rregullatore referuar në Nenin 22(2). Këto rregulla do të marrin parasysh standardet përkatëse ekzistuese ndërkombëtare dhe kërkesat e përdoruesit, në veçanti në lidhje me vërtetimin e metadatave.

Neni 6

Shtetet Anëtare do të krijojnë metadata referuar në Nenin 5 në përputhje me kalendarin vijues:

- (a) jo më vonë se 2 vjet pas datës së adoptimit të implementimit të rregullave në përputhje me Nenin 5(4) në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që korrespondojnë me temat e listuar në Aneksat I dhe II;
- (b) jo më vonë se 5 vjet pas datës së datës së adoptimit të implementimit të rregullave në përputhje me Nenin 5(4) në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që korrespondojnë me temat e listuar në Aneksat III.

KAPITULLI III

NDËRVEPRIMI I GRUPEVE DHE SHËRBIMEVE TË TË DHËNAVE HAPËSINORE

Neni 7

1. Implementimi i rregullave që përcaktojnë marrëveshjet teknike për ndërveprim dhe, sipas rastit, harmonizimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore, projektuar për të amenduar elemente jo thelbësorë të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, do të miratohet në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar në Nenin 22(3). Kërkesat përkatëse të përdoruesit, nismat ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare për harmonizimin e grupeve të të dhënave hapësinore, si dhe konsideratat për fizibilitetin dhe përfitimet në kosto do të merren parasysh në zhvillimin e implementimit të rregullave. Aty ku organizata të themeluara sipas të drejtës ndërkombëtare kanë miratuar standarde përkatëse për të siguruar ndërveprimin ose harmonizimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore, këto standarde do të integrohen dhe mjetet ekzistues teknike do t'i referohen, nëse është e përshtatshme, implementimit të rregullave të përmendura në këtë paragraf.

2. Si një bazë për zhvillimin e rregullave të implementimit parashikuar në paragrafin 1, Komisioni do të ndërmarrë analiza për të siguruar që rregullat janë të realizueshme dhe proporcionale në aspektin e kostove dhe përfitimeve të tyre të mundshme dhe do të ndajnë rezultatet e analizave të tilla me komitetin e referuar në Nenin 22(1). Shtetet Anëtare, bazuar në një kërkesë, do t'i ofrojnë Komisionit informacionin e nevojshëm për t'i mundësuar të ndërmarrin analiza të tilla.

3. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të gjitha strukturat e reja të mbledhura gjerësisht dhe shërbimet përkatëse të të dhënave hapësinore janë të disponueshme në përputhje me implementimin e rregullave referuar në paragrafin 1 brenda dy viteve nga adoptimi i tyre, dhe se komplete dhe shërbime të tjera të dhënash hapësinore ende në përdorim janë të disponueshme në përputhje me implementimin e rregullave brenda shtatë vitesh nga adoptimi i tyre. Grupet e të dhënave hapësinore do të bëhen të disponueshme me implementimin e rregullave ose përmes përshtatjes së grupeve ekzistuese të të dhënave hapësinore ose përmes shërbimeve të transformimit referuar në pikën (d) të Nenit 11(1).

4. Rregullat e implementimit referuar në paragrafin 1 do të përfshijnë përkufizimin dhe klasifikimin e objekteve hapësinore lidhur me grupet e të dhënave hapësinore të temave listuar në Aneksin I, II dhe III dhe mënyra në të cilën këto të dhëna hapësinore kanë një gjeo-referencë.

5. Përfaqësues të Shteteve Anëtare në nivel kombëtar, rajonal

dhe lokal si dhe persona të tjerë fizikë apo juridikë me një interes në të dhënat hapësinore, që lidhen me rolin e tyre në infrastrukturën e informacionit hapësinor, përfshi përdorues, prodhues, ofrues shërbimesh me vlerë të shtuar ose çdo organ koordinues do t'i jepet

mundësia për marrë pjesë në diskutimet përgatitore për përmbajtjen e rregullave të implementimit referuar në paragrafin 1, para se të merret parasysh nga Komiteti referuar Nenin 22(1).

Neni 8

1. Në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që i korrespondojnë një ose më shumë tema të listuar në Aneksin I ose II, rregullat e implementimit parashikuar nga Neni 7(1) do të plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij Neni.

2. Rregullat e implementimit do të adresojnë aspektet vijuese të të dhënave hapësinore:

- (a) një strukturë të përbashkët për identifikimin unik të objekteve hapësinore ku mund të hidhen në hartë identifikuesit sipas sistemeve kombëtare për të garantuar ndërveprim mes tyre;
- (b) marrëdhënia mes objekteve hapësinore;
- (c) cilësitë kyçe dhe fjalori përkatës shumë gjuhësh, i cili kërkohet për politikat që kanë ndikim në mjedis;
- (d) informacion mbi dimensionin e përkohshëm të të dhënave;
- (e) përditësime të të dhënave.

3. Rregullat e implementimit do të projektohen për të siguruar përputhshmëri mes artikujve të informacionit, të cilat i referohen të njëjtës vendndodhje ose mes artikujve të informacionit, që i referohen të njëjtit objekt prezantuar në shkallë të ndryshme.

4. Rregullat e implementimit do të projektohen për të siguruar që informacioni, i cili rrjedh nga struktura të ndryshme hapësinore është i krahasueshëm për sa i përket aspekteve referuar Nenin 7(4) dhe paragrafit 2 të këtij Neni.

Neni 9

Rregullat e implementimit parashikuar në Nenin 7(1) do të miratohen në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:

- (a) jo më vonë se 15 Maj 2009 në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që iu korrespondojnë temave të listuar në Aneksin I;
- (b) jo më vonë se 15 Maj 2012 në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që iu korrespondojnë temave të listuar në Aneksin II ose III.

Neni 10

1. Shtetet Anëtare do të garantojnë që çdo informacion, përfshi të dhëna, kode dhe klasifikime teknike, të cilat duhen për përputhjen

me rregullat e implementimit parashikuar nga Neni 7(1) të bëhet i disponueshëm për autoritetet publike ose palët e treta në përputhje me kushtet, që nuk kufizojnë përdorimin për këtë qëllim.

2. Për të garantuar që të dhënat hapësinore lidhur me një veçori gjeografike, vendndodhja e të cilës shtrihet mes kufijve të dy ose më shumë Shteteve Anëtare, janë koherente, Shtetet Anëtare, sipas rastit, do të vendosin me miratim reciprok mbi përshkrimin dhe pozicionin e veçorive të tilla të përbashkëta.

KAPITULLI IV

SHËRBIMET E RRJETIT

Neni 11

1. Shtetet Anëtare do të ngrenë dhe operojnë një rrjet shërbimesh të mëposhtme për grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore për të cilat janë krijuar metadatat në përputhje me këtë Direktivë:

- (a) shërbime zbuluese bëjnë të mundur kërkimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore bazuar në përmbajtjen e metadatave përkatëse për të shfaqur përmbajtjen e metadatave;
- (b) shërbime pamore duke bërë të mundur, si një kërkesë minimale, shfaqjen, navigimin, zmadhimin/zvogëlimin, panoramimin, ose mbulimin e grupeve të të dhënave hapësinore dhe shfaqjen e informacionit të legjendave dhe çdo përmbajtje përkatëse të metadatave;
- (c) shkarkimi i shërbimeve, duke mundësuar kopje të grupeve të të dhënave hapësinore, ose pjesë të grupeve të tilla, për t'u shkarkuar dhe, sipas rastit, për t'u aksesuar direkt;
- (d) shërbime transformimi, duke mundësuar grupe të të dhënave hapësinore për t'u transformuar me qëllim aritjen e ndërveprimit;
- (e) shërbime që lejojnë përdorimin e shërbimeve të të dhënave hapësinore.

Këto shërbime do të marrin parasysh kërkesat përkatëse të përdoruesit dhe do të jenë të lehta në përdorim, të disponueshme për publikun dhe të aksesueshme përmes Internetit ose çdo mjeti tjetër të përshtatshëm telekomunikacioni.

2. Për qëllim të këtyre shërbimeve referuar pikës (a) të paragrafit 1, si një kërkesë minimale do të implementohet kombinimi vijues i kritereve të kërkimit:

- (a) fjalët kyçe;
- (b) klasifikimi i të dhënave dhe shërbimeve hapësinore;

(c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave hapësinore;

- (d) shkalla e përputhshmërisë me rregullat e implementimit parashikuar nga Neni 7(1);
- (e) vendndodhja gjeografike;
- (f) kushtet që zbatohen për të hyrë dhe përdorur grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore;
- (g) autoritetet publike përgjegjëse për ngritjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore.
3. Shërbimet e transformimit referuar pikës (d) të paragrafit 1 do të kombinohen me shërbime të tjera referuar po këtij paragrafi në një mënyrë të tillë që të mundësojë të gjitha këto shërbime, të cilat do të operojnë në përputhje me rregullat e implementimit parashikuar nga Neni 7(1).
- (e) të drejtat e pronësisë intelektuale;
- (f) konfidencialiteti i të dhënave personale dhe/ose dosjeve lidhur me një person fizik kur ai person nuk ka miratuar zbulimin e informacionit për publikun, ku një konfidencialitet i tillë parashikohet nga ligji kombëtar ose komunitar;
- (g) interesat ose mbrojtja e çdo personi, që ka siguruar informacionin e kërkuar vullnetarisht pa qenë i detyruar ose vënë nën detyrimin ligjor për të kryer një gjë të tillë, nëse ai person ka dhënë pëlqimin për lëshimin e informacionit përkatës;
- (h) mbrojtja e mjedisit me të cilin lidhet një informacion i tillë, si vendndodhja e specieve të rralla.

Neni 12

Shtetet Anëtare do të garantojnë që autoritetet publike kanë mundësinë teknike për të lidhur grupet dhe shërbimet e të dhënave të tyre hapësinore me rrjetin referuar Neni 11(1). Ky shërbim do të bëhet gjithashtu i disponueshëm sipas kërkesës për palët e treta, grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore të të cilave përputhen me rregullat e implementimit që përcaktojnë detyrime në lidhje me metadat në veçanti, dhe me shërbimet e rrjetit dhe ndërveprimin.

Neni 13

1. Duke anashkaluar Nenin 11(1), Shtetet Anëtare mund të kufizojnë qasjen publike në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore përmes shërbimeve referuar pikës (a) të Neni 11(1) ku një qasje e tillë ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurinë publike dhe mbrojtjen kombëtare.

Duke anashkaluar Nenin 11(1), Shtetet Anëtare mund të kufizojnë qasjen publike në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore përmes shërbimeve referuar pikëve (b) deri në (e) të Neni 11(1),

- (a) konfidencialiteti i procedimeve të autoriteteve publike, ku një konfidencialitet i tillë parashikohet nga ligji;
- (b) marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike ose mbrojtja kombëtare;
- (c) rrjedha e drejtësisë, aftësia e çdo personi për të pasur një gjykim të drejtë ose aftësia e një autoriteti publik për të kryer një hetim të një natyre kriminale ose disiplinore;
- (d) konfidencialiteti i informacionit tregtar ose industrial, ku një konfidencialitet i tillë parashikohet nga ligji kombëtar ose komunitar për të mbrojtur një interes të ligjshëm ekonomik, përfshi interesin publik në mirëmbajtjen e konfidencialitetit statistikor dhe fshehtësisë së taksave;

2. Arsytet për kufizimin e qasjes, siç parashikohet nga paragrafi 1, do të interpretohen në një mënyrë kufizuese, duke marrë parasysh rastin e veçantë të interesit publik paraqitur nga kjo qasje. Në çdo rast të veçantë, interesi publik i shprehur përmes zbulimit do të peshohet përkundrajt interesit të shprehur përmes kufizimit ose kushtëzimit të qasjes. Bazuar në pikat (a), (d), (f), (g) dhe (h) të paragrafit 1, Shtetet Anëtare nuk mund të kufizojnë qasjen në informacionin e emetimeve në mjedis.

3. Brenda kësaj strukture, dhe për qëllim të zbatimit të pikës (f) të paragrafit 1, Shtetet Anëtare do të garantojnë që të përputhen kërkesat e Direktivës 95/46/KE.

Neni 14

1. Shtetet Anëtare do të garantojnë që shërbimet referuar nga pikat (a) dhe (b) të Neni 11(1) janë të disponueshme falas për publikun.

2. Duke anashkaluar paragrafin 1, Shtetet Anëtare mund të lejojnë një autoritet publik të ofrojnë një shërbim referuar pikës (b) të Neni 11(1) për të aplikuar tarifa ku tarifa të tilla sigurojnë mirëmbajtjen e grupeve dhe shërbimeve përkatëse të të dhënave hapësinore, veçanërisht në rastet ku përfshihen volume të mëdha të dhënash vazhdimisht të përditësuara.

3. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes shërbimeve pamore referuar nga pika (b) e Neni 11(1) mund të jenë në formën e parandalimit të ripërdorimit të tyre për qëllime tregtare.

4. Aty ku autoritetet publike vënë taksë për shërbimet e referuar në pikat (b), (c) ose (e) të Neni 11(1), Shtetet Anëtare do të garantojnë që shërbimet e tregtisë elektronike të jenë të disponueshme. Shërbimet të tilla mund të mbulohen nga deklaratat e mospranimit, licencat e klikimeve ose, aty ku është e nevojshme, licencat.

Neni 15

1. Komisioni do të ngrejë dhe operojë një gjeo-portal Inspire në nivel komunitar.
2. Shtetet Anëtare do t'iu ofrojnë qasje shërbimeve referuar nga Neni 11(1) përmes gjeo-portalit Inspire referuar nga paragrafi 1. Shtetet Anëtare mund të ofrojnë gjithashtu qasje në këtë shërbime përmes pikave të tyre të qasjes.

duke respektuar kërkesat vetë-financuese të autoriteteve publike, që plotësojnë grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore sipas rastit. Grupet

Neni 16

Rregullat për implementimin projektuar për të amenduar elementet jo thelbësorë të këtij Kapitulli duke e plotësuar atë, do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar në Nenin 22(3), dhe do të përcaktojnë sidomos të mëposhtmet:

- (a) specifikimet teknike për shërbimet referuar nga Nenet 11 dhe 12 dhe kriteret minimale të performancës për këto shërbime, duke marrë parasysh kërkesat ekzistuese të raportimit dhe rekomandimet e miratuara brenda strukturës së legjisllacionit mjedisor komunitar, shërbimet ekzistuese të tregtisë elektronike dhe progresin teknologjik;
- (b) detyrimet referuar nga Neni 12.

KAPITULLI V

NDARJA E TË
DHËNAVE*Neni 17*

1. Shtetet Anëtare do të adoptojnë masat për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore mes autoriteteve publike referuar nga pika (9)(a) dhe (b) të Nenin 3. Këto masa do t'iu mundësojnë autoriteteve publike të fitojnë qasje në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore, dhe të shkëmbejnë e të përdorin ato grupe dhe shërbime, për qëllim të detyrave publike që mund të kenë një ndikim në mjedis.

2. Masat e parashikuara në paragrafin 1 do të pengojnë çdo kufizim të mundshëm të krijojnë pengesa praktike, të cilat ndodhin gjatë përdorimit, për të ndarë grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore.

3. Shtetet Anëtare mund të lejojnë autoritetet publike që japin grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore të marrin licencën, dhe/ose të kërkojnë pagesë nga autoritetet publike ose institucionet dhe organet e Komunitetit, që përdorin këtë grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore. Çdo tarifë dhe licencë e tillë duhet të jetë e pajtueshme me synimin e përgjithshëm të lehtësimit të ndarjes së grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore mes autoriteteve publike. Kur vihen tarifa, këto do të mbahen në nivelin e kërkuar minimal për të garantuar cilësinë e nevojshme dhe plotësimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore së bashku me një kthim të arsyeshëm investimesh,

dhe shërbimet e të dhënave hapësinore parashikuar nga Shtetet Anëtare për institucionet komunitare për të përmbushur detyrimet e tyre për raportim sipas legjislacionit komunitar lidhur me mjedisin nuk do t'i nënshtrohet asnjë tarife.

4. Marrëveshjet për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore parashikuar nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të jenë të hapura për autoritetet publike referuar pikës (9)(a) dhe (b) të Nenit 3 të Shteteve të tjera Anëtare dhe të institucioneve dhe organeve komunitare, për qëllim të detyrave publike që mund të kenë ndikim në mjedis.

5. Marrëveshjet për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore parashikuar nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të jenë të hapura, mbi baza reciproke dhe të barasvlershme, për organet e themeluara me marrëveshje ndërkombëtare në të cilat Komuniteti dhe Shtetet Anëtare janë palë, për qëllim të detyrave që mund të kenë ndikim në mjedis.

6. Aty ku marrëveshjet për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore parashikuar nga paragrafët 1, 2 dhe 3 janë bërë të disponueshme në përputhje me paragrafët 4 dhe 5, këto marrëveshje mund të shoqërohen nga kërkesa sipas ligjit kombëtar që kushtëzon përdorimin e tyre.

7. Duke anashkalluar këtë Nen, Shtetet Anëtare mund të kufizojnë ndarjen kur kjo do të kompromentonte rrjedhën e drejtësisë, sigurinë publike, mbrojtjen kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare.

8. Shtetet Anëtare do t'iu japin institucioneve dhe organeve të Komunitetit qasje në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore në përputhje me kushtet e harmonizuara. Rregullat e implementimit që përcaktojnë këto kushte projektuar për të amenduar elementet jo thelbësorë të kësaj Direktive duke i plotësuar, do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar nga Neni 22(3). Këto rregulla implementimi do të respektojnë plotësisht parimet e parashikuar në paragrafët 1 deri në 3.

KAPITULLI VI

KOORDINIMI DHE MASAT PLOTËSUESE

Neni 18

Shtetet Anëtare do garantojnë që strukturat dhe mekanizmat e përshtatshme janë projektuar për koordinim, në nivele të ndryshme qeverisëse, kontributet e të gjithë atyre me një interes në infrastrukturën për informacionin hapësinor.

Këto struktura do të koordinojnë, ndër të tjera, kontributet e përdoruesve, prodhuesve, ofruesve të shërbimeve me vlerë të shtuar dhe organeve koordinuese, lidhur me identifikimin e grupeve të të dhënave përkatëse, nevojave të përdoruesve, dispozitën e informacionit mbi praktikën ekzistuese dhe dispozitën e reagimeve në implementimin e kësaj Direktive.

Neni 19

1. Komisioni do të ketë përgjegjësinë për koordinimin e Inspire në nivel komunitar dhe për këtë qëllim do të asistohet nga organizatat përkatëse dhe, në veçanti, nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

2. Secili Shtet Anëtar do të caktojë një pikë kontakti, zakonisht një autoritet publik, për të qenë përgjegjës për kontaktet me Komisionin lidhur me Direktivën. Kjo pikë kontakti do të mbështetet nga një strukturë koordnimit, duke marrë parasysh shpërndarjen e kompetencave dhe përgjegjësiive brenda Shtetit Anëtar.

Neni 20

Rregullat e implementimit referuar nga kjo Direktivë do të marrin parasysh standardet e miratuara nga organet evropiane të standardizimit në përputhje me procedurën e parashikuar në Direktivën 98/34/KE, si dhe me standardet ndërkombëtare.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT
PËRFUNDIMTARE*Neni 21*

1. Shtetet Anëtare do të monitorojnë implementimin dhe përdorimin e infrastrukturës së tyre për informacion hapësinor. Ata do t'i bëjnë rezultatet e këtij monitorimi të aksesueshëm për Komisionin dhe publikun në mënyrë të përhershme.

2. Jo më vonë se 15 Maj 2010 Shtetet Anëtare do t'i dërgojnë Komisionit një raport ku përfshihet përshkrimi përmbledhës i:

- (a) mënyrës si janë koordinuar ofruesit e sektorit publik dhe përdoruesit e grupeve e shërbimeve të të dhënave hapësinore si dhe organeve ndërmjetëse, gjithashtu edhe të marrëdhënies me palët e treta dhe organizimit të sigurimit të cilësisë;
- (b) kontributit të bërë nga autoritetet publike ose palët e treta për funksionimin dhe koordinimin e infrastrukturës për informacionin hapësinor;
- (c) informacionit mbi përdorimin e infrastrukturës së informacionit hapësinor;
- (d) marrëveshjet e ndarjes së të dhënave mes autoriteteve publike;
- (e) kostot dhe përfitimet e implementimit të kësaj Direktive.

3. Çdo tre vjet, dhe duke filluar jo më vonë se 15 Maj 2013, Shtetet Anëtare do t'i dërgojnë Komisionit një raport ku jepen informacione të përditësuara në lidhje me artikujt e referuar nga paragrafi 2.

4. Rregullat e hollësishme për implementimin e këtij Nenin do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore referuar nga Neni 22(2).

Neni 22

1. Komisioni do të asistohet nga një komitet.

2. Kur i bëhet referencë këtij paragrafi, do të zbatohen Nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/EC, duke pasur parasysh dispozitat e Nenit 8.

Periodha e parashikuar në Nenin 5(6) të Vendimit 1999/468/EC do të caktohet për tre muaj.

3. Kur i bëhet referencë këtij paragrafi, do të zbatohet Neni 5a(1) deri në Nenin 7 të Vendimit 1999/468/EC, duke pasur parasysh dispozitat e Nenit 8.

Neni 23

Brenda 15 Maj 2014 dhe çdo gjashtë vjet Komisioni do t'i paraqesë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport mbi implementimin e kësaj Direktive bazuar, ndër të tjera, në raporte të Shteteve Anëtare në përputhje me Nenin 21(2) dhe (3).

Ku të jetë e nevojshme, raporti do të shoqërohet me propozime për veprime të Komunitetit.

Neni 24

1. Shtetet Anëtare do të sjellin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat e nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive brenda 15 Maj 2009.

Kur Shtetet Anëtare adoptojnë këto masa, do t'i përmbahen një reference nga kjo Direktivë ose do të shoqërohen nga një referencë e tillë në rastin e publikimit të tyre zyrtar. Metodot e krijimit të një reference të tillë do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar, të cilin e miratojnë në fushën e përfshirë nga kjo Direktivë.

Neni 25

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e 20-të pas publikimit të saj në *Revistën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Neni 26

Kjo Direktivë iu adresohet Shteteve Anëtare.

Realizuar në Strasburg, 14 Mars 2007.

*Për Parlamentin
Evropian*

Presidenti
H.-G. PÖTTERING

Për Këshillin

Presidenti
G. GLOSER

ANEKSI I

TEMAT E TË DHËNAVE HAPËSINORE REFERUAR ARTIKUJVE 6(A), 8(1) DHE 9(A)

1. Sistemet e referencës së koordinatave

Sisteme për referencën unike të informacionit hapësinor në hapësirë si një strukturë koordinatash (x, y, z) dhe/ose gjerësia, gjatësia dhe lartësia, bazuar në një të dhënë gjeodezike horizontale dhe vertikale.

2. Sistemet e rrjetit gjeografik

Rrjet i harmonizuar me shumë zgjidhje me një pikë të përbashkët origjine, vendndodhjeje të standardizuar dhe madhësie të qelizave të rrjetit.

3. Emra gjeografikë

Emrat e zonave, lokaliteteve, qyteteve, periferive, qytezave ose vendbanimeve, ose çdo veçorie gjeografike apo topografike të publikut ose interesit historik.

4. Njësitë administrative

Njësitë e administrimit, zonat ndarëse ku Shtetet Anëtare kanë dhe/ose shfrytëzuar të drejtat juridiksionale, për qeverisjen lokale, rajonale dhe kombëtare, ndarë me kufij administrativë.

5. Adresat

Vendndodhja e pronave bazuar në identifikuesit e adresave, zakonisht sipas emrit të rrugës, numrit të shtëpisë, kodit postar.

6. Parcelat kadastrale

Zonat e përkufizuara nga regjistrat kadastralë ose të barasvlershëm me to.

7. Rrjetet e transportit

Rrjetet e transportit rrugor, hekurudhor, ajror e ujor dhe infrastruktura përkatëse. Përfshin lidhje mes rrjeteve të ndryshme. **Gjithashtu përfshin rrjetet e transportit trans-evropian siç përcaktohet nga Vendimi Nr. 1692/96/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit që prej 23 Korrik 1996 mbi Udhëzimet Komunitare për zhvillimin e rrjetit ⁽¹⁾ të transportit trans-evropian dhe rishikimeve të ardhshme të këtij Vendimi.**

8. Hidrografia

Elementet hidrografikë, përfshi zonat detare dhe të gjithë organet e tjerë ujorë dhe artikujt e lidhur me to, përfshi basenët dhe nënbasenët lumorë. **Sipas rastit, në përputhje me përkufizimet e përcaktuara në Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 Tetor 2000 ku krijohet një strukturë për veprim komunitar në fushën e politikës së ujit ⁽²⁾ dhe në formën e rrjeteve.**

9. Vende të mbrojtura

Zonë e projektuar ose menaxhuar brenda një strukture legjislacioni ndërkombëtar, komunitar dhe të Shteteve Anëtare për të arritur objektiva specifike mbrojtjeje.

⁽¹⁾ OJ L 228, 9.9.1996, fq. 1. Vendimi amenduar së fundmi nga Këshilli Rregullator (KE) Nr. 1791/2006 (OJ L 363, 20.12.2006, fq. 1). ⁽²⁾ OJ L 327, 22.12.2000, fq. 1. Direktiva amenduar nga Vendimi Nr. 2455/2001/KE (OJ L 331, 15.12.2001, fq. 1).

ANEKSI II

TEMAT E VEÇANTA TË TË DHËNAVE REFERUAR NGA NENET 6(A), 8(1) DHE 9(B)

1. Lartësimi

Modelet e lartësimit digjital për tokën, akullin dhe sipërfaqen e oqeanit. Përfshin lartësimin tokësor, batimetrinë dhe bregdetin.

2. Mbulimi tokësor

Mbulimi fizik dhe biologjik i sipërfaqes së tokës përfshin sipërfaqet artificiale, zonat agrikuturore, pyjet, zonat (gjysmë)natyrale, ligatinat, organet ujore.

3. Ortoimazheria

Të dhëna pamjesh me gjeo-referencë të sipërfaqes së Tokës, nga sateliti ose sensorë ajrorë.

4. Gjeologjia

Gjeologjia është karakterizuar në përputhje me përbërjen dhe strukturën. Përfshin aluvionin, ujërat nëntokësorë dhe gjeomorfologjinë.

ANEKSI II

TEMAT E VEÇANTA TË TË DHËNAVE REFERUAR NGA NENET 6(B) DHE 9(B)

1. Njësitë statistikore

Njësitë për përhapjen ose përdorimin e informacionit statistikor.

2. Ndërtesat

Vendndodhja gjeografike e ndërtesave

3. Dheu

Dheu dhe tabani karakterizuar në përputhje me thellësinë, përbërjen, strukturën dhe përmbajtjen e grimcave dhe materialeve organike, shtresën gurore, erozionin, sipas rastit nënkupton shpat dhe kapacitetin e parashikuar për grumbullimin e ujit.

4. Përdorimi i tokës

Territori i karakterizuar në përputhje me dimensionin e planifikuar funksional aktual dhe të ardhshëm ose me qëllimin shoqëror-ekonomik d.m.th. rezidencial, industrial, tregtar, agrikulturor, rekreacional dhe të pylltarisë).

5. Shëndeti dhe siguria e njeriut

Shpërndarja gjeografike e mbizotërimit të patologjive (alergjitë, kanceri, sëmundjet respiratore, etj.) informacioni që tregon ndikimin në shëndet (shenjat biologjike, rënia e fertilitetit, epidemitë) ose mirëqenia e njerëzve (lodhja, stresi, etj.) lidhur direkt (ndotja e ajrit, lëndët kimike, shterimi i shtresës së ozonit, zhurma, etj.) ose indirekt (ushqimi, organizmat e modifikuar gjenetikisht, etj.) me cilësinë e mjedisit.

6. Shërbimet utilitare dhe qeveritare

Përfshin objektet e utiliteteve siç janë ujërat e zeza, menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me energji dhe ujë, shërbimet qeveritare shoqërore dhe administrative siç janë administratat publike, vendet e mbrojtjes civile, shkollat dhe spitalet.

7. Objektet e monitorimit të mjedisit

Vendndodhja dhe operimi i objekteve të monitorimit të mjedisit përfshin vëzhgimin dhe matjen e emetimeve, të gjendjes së mjeteve të komunikimit mjedisor dhe të parametrave të tjerë të ekosistemit (biodiversiteti, kushtet ekologjike të vegetacionit, etj.) nga ose në emër të autoriteteve publike.

8. Objektet industriale dhe të prodhimit

Vende industriale të prodhimit, duke përfshirë instalimet e mbuluara nga Direktiva e Këshillit 96/61/KE i 24 Shtator 1996 lidhur me parandalimin e integruar të ndotjes dhe kontrollin e saj (1) dhe objektet e nxjerrjes së ujit, minierat, vendet e magazinimit.

9. Objekte agrikulturore dhe akuakulturore

Pajisje bujqësore dhe objekte prodhimi (përfshi sistemet e ujitjes, serat dhe stallat).

10. Shpërndarja e popullatës — demografia

Shpërndarja gjeografike e njerëzve, përfshi karakteristikat e popullsisë dhe nivelet e aktivitetit, grumbulluar nga rrjeti, rajoni, njësia administrative ose njësi tjetër analitike.

11. Menaxhimi i zonës/kufizimi/zonat e rregullimit dhe njësitë e raportimit

Zonat e menaxhuara, të rregulluara ose përdorura për raportim në nivele ndërkombëtare, evropiane, kombëtare, rajonale dhe lokale. Përfshin vendet e hedhjes, zonat e kufizuara rreth burimeve të ujit të pijshëm, zonat e rrezikuara nga nitratet, rrugët e rregulluara në det ose në ujërat e mëdha në brendësi të tokës, zonat për hedhjen e mbeturinave, zonat e kufizimit të zhurmës, zonat e lejes për kërkim dhe nxjerrje minerare, zona të basenit lumor, njësitë përkatëse të raportimit dhe fushat e menaxhimit të zonës bregdetare.

(1) OJ L 257, 10.10.1996, fq. 26. Direktiva amenduar së fundmi nga Rregullorja (KE) Nr. 166/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (OJ

12. Zonat e rrezikut natyror

Zonat e rrezikuara karakterizuar sipas rreziqeve natyrore (të gjithë fenomenet atmosferikë, hidrologjikë, sizmikë, vullkanikë dhe lëndëve djegëse, për shkak të vendndodhjes së tyre, ashpërsisë dhe frekuencës, kanë potencial të ndikojnë seriozisht në shoqëri), p.sh. përmytjet, rrëshqitjet e tokës dhe fundosjet, orteqet, zjarret e pyjeve, tërmetet, shpërthimet vullkanike.

13. Kushtet atmosferike

Kushtet fizike në atmosferë. Përfshin të dhëna hapësinore bazuar në matje, modele ose në një kombinim dhe përfshin vendndodhjet e matjeve.

14. Veçoritë meteorologjike gjeografike

Kushtet e motit dhe matjet e tyre; reshjet, temperatura, avullimi dhe djersitja, shpejtësia e erës dhe drejtimi.

15. Veçoritë oqeanografike gjeografike

Kushtet fizike të oqeaneve (rrymat, kripësia, lartësia e dallgëve, etj.).

16. Rajonet detare

Kushtet fizike të deteve dhe organet e ujit të kripur të ndarë në rajone dhe nën-rajone me karakteristika të përbashkëta.

17. Rajonet bio-gjeografike

Fusha me kushte ekologjike relativisht homogjene me karakteristika të përbashkëta.

18. Habitatet dhe biotipet

Zonat gjeografike karakterizuar nga kushte të veçanta ekologjike, procese, struktura dhe funksione të (mbështetjes së jetës), që mbështesin fizikisht organizmat që jetojnë aty. Përfshin zonat tokësore dhe ujore të cilat dallohet nga veçoritë gjeografike, abiotike dhe biotike, qofshin tërësisht natyrore ose gjysmë-natyrore.

19. Shpërndarja e specieve

Shpërndarja gjeografike e zhvillimit të llojeve bimore dhe shtazore grumbulluar nga rrjeti, rajoni, njësi administrative ose njësi tjetër analitike.

20. Burimet e energjisë

Burimet e energjisë përfshi hidrokarburet, energjinë hidroelektrike, bio-energjinë, energjinë diellore, të erës, etj. aty ku është e nevojshme, duke përfshirë informacionin e thellësisë/lartësisë në masën e burimit.

21. Burimet minerale

Burimet minerale përfshi xeherorë metalesh, minerale industriale, etj., aty ku është e nevojshme, duke përfshirë informacionin e thellësisë/lartësisë në masën e burimit.
